



Pranuar / Dostaviti Prilaziti / Prilazilo Received / Delivered	08.11.2023	3	viti god. year
Organi / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Pr. Prof. Pr. Prof. Prof. No	Shtojca Prlodog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SH/046940/2023			1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic o Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD OR THE CIVIL SERVICE O KOSOVA

A.nr.1325/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Arben Mehmeti dhe Arditë Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, si procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1325/2023 të datës 24.10.2023 të parashtruar nga grup ankuesish

Komuna e Lipjanit, kundër organit të punësimit/Komuna e Lipjanit, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafi 3; nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 07.11.2023 mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.1325/2023 e datës 24.10.2023 e parashtruar nga grup ankuesish

A r s y e t i m i

Nëpunësja civile e punësuar sipas akt emërimit Nr. Port: 1-111-01-3050/2023 të datës 14.06.2023 në pozitën "Zyrtar i Depos 1", si dhe e punësuar sipas akt emërimit Nr.Port:1-112/02-5251/2022 pozitën e punës "Zyrtar i Depos 1", në Komunën e Lipjanit, më datë 13.10.2023 kanë parashtruar kërkesë tek Sektori për Personel në Komunën e Lipjanit, me pretendim për ndryshim- përmirësimin e koeficientit për pozitën Zyrtare e Depos -1 nga Profesional-3 në Profesional -2 .Ndërsa kjo e fundit me datën 23.10.2023 iu është përgjigjur në kërkesën me 1-120/04-59129 ka njoftuar ankueset se, sa i përket kërkesës suaj kategoria profesionale 3 është e barazvlefshme me pozitën e punës dhe përshkrimin e detyrave të punës dhe se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ju njofton se komisioni i DMZP-së ka vendosur për të gjithë koeficientet e Zyrtareve Komunal te Lipjanit dhe ka ranguar sipas pozitive të punës dhe kategorisë funksionale dhe ne si Njësi e Burimeve Njerëzore vetëm e kemi zbatuar klasifikimin nga DMZP-ja.

Ankueset dhe më datë 24.10.2023 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 6670/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor me kërkesë për përmirësim të koeficientit nga "Profesional 3" në "Profesional 2".

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 26.10.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Kjo e fundit, më datë 31.10.2023, i përcolli shkresat e lëndës lidhur me çështjen për vendosje.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës si dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e palejuar sepse:*

Ankueset në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë se në listën e DMP-Së të përcjell tek organi i punësimit është bere shkelje, diskriminim, krahas funksionit dhe punës qe kryejnë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankueseve, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2 paragrafi 1 në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: "1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj", dhe nenin 14 paragrafi 3 të këtij ligji ku përcaktohet se: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe si rrjedhojë, referuar këtij përcaktimi ligjor Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e përcaktuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, në këtë rast në pajtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publikë dhe Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se organi i punësimit, gjegjësisht Komuna e Lipjanit, ende nuk e ka përfunduar procesin e klasifikimit të vendeve të punës për nëpunësit civil në kuadër të këtij institucioni, dhe se procesimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i ekuivalencës së sistemit të vjetër me sistemin e ri të koeficienteve të përcaktuar me Vendimin Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Andaj, duke qenë se me nenin 29 të Rregullores (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe më pikën 5 dhe 6 të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, institucionet e administratës publike janë obliguar që të përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitave të punës në pajtim me këtë Rregullore dhe

katalogun e vendeve të punës, jo më vonë se nëntë (9) muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, përkatësisht deri me datë 30.09.2023, i cili afat me vendim të Qeverisë së Kosovës Nr.17/162 të datës 27.09.2023 është ndryshuar me që rast Institucionet kanë obligim ligjorë që të përfundojnë klasifikimin e vendeve të punës deri më datë 31.12.2023, Kolegji i Këshillit vlerëson se ankesa e ankuesit lidhur me kategorizimin e pozitës së tij është e parakohshme dhe si e tillë në këtë fazë nuk i plotëson kushtet ligjore për trajtim meritior, rrjedhimisht e njëjta është e papranueshme edhe në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në at që u tha më lartë, vlerëson se vetëm pas përfundimit të procesit të klasifikimit të pozitive të punës nga organi përkatës i punësimit, sipas procedurës dhe afatit të theksuar me lartë, ankuesit i lindë e drejta e kundërshtimit dhe ankimit lidhur me klasifikimin e pozitës së tij të punës.

Kështu që mbështetur në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1325/2023,.

Ilire MEHMETI- SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI- BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve
- Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit
- Arkivit të KPMSHCK-së.

